



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 748 , datë 1.12.2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË
SË BRIGJEVE TË BURIMEVE UJORE**

Në mbështetje të shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është:

- a) përcaktimi i zonës, distancës dhe gjerësisë së bregut të burimit ujqor, bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, të parashikuara në këtë vendim, konkretisht të:
 - i. brigjeve përgjatë detit;
 - ii. brigjeve në liqene, rezervuarë natyrorë apo artificialë, laguna, pellgje me ujë, duke përfshirë këtu liqenet, rezervuarët ujqorë, natyrorë apo artificialë;
 - iii. brigjeve përgjatë lumenjve dhe përrenjve;
 - iv. brigjeve përgjatë kanaleve artificiale.
- b) përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për miratimin e hartave të brigjeve.

2. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Gjerësi e bregut”**, gjerësia e hapësirës tokësore nga brinja e sipërme e shtratit të burimit ujq në drejtim të tokës.
- b) **“Seksion i sistemuar”**, ajo pjesë e një trupi ujq në të cilin janë kryer ndërhyrje infrastrukturore hidroteknike të nevojshme për sistemimin e ujërave natyrore ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, me veshje dhe/ose riprofilim të ndryshëm nga gjendja natyrore e cila siguron kalimin e prurjes maksimale të llogaritur.
- c) **“Shtrati i burimit ujq”**, terreni natyror ose artificial, nëpër të cilin, përherë apo përkohësisht, rrjedh ose qëndron uji.
- ç) **“Vijë bregdetare”** ose **“vija e bregdetit”**, vija që formon kufirin midis bregdetit (tokës) dhe zonës së bregut.
- d) **“Vijë ujore”** ose **“vijë e bregut të trupit ujq”**, kufiri ujë-tokë.
- dh) **“Zonë e bregut të burimit ujq”**, hapësira tokësore nga brinja e sipërme e shtratit të burimit ujq që shtrihet në drejtim të tokës, sipas gjerësisë së përcaktuar në bazë të kriterëve të përgjithshme e të posaçme.
- e) **“Zona e bregut të detit”**, hapësira që krijohet ndërmjet kufirit ujë-tokë, i cili referuar vendimit nr.1018, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri-tema: detet”, është niveli i ujit të detit në baticë dhe vijës bregdetare dhe ku çdo ekosistem bregdetar natyror përfshihet në këtë hapësirë.

II. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË SË BREGUT TË BURIMIT UJQ

3. Zona, distanca dhe gjerësia e bregut të burimit ujq përcaktohet në bazë të këtyre kriterëve të përgjithshme, si më poshtë vijon:
 - a) Tipologjisë së burimit ujq (i rrjedhshëm apo i qëndrueshëm);
 - b) Ruajtjes së ekosistemeve;
 - c) Sigurimit të vazhdimësisë së rrjedhës së trupave ujorë gjatë prurjeve maksimale;
 - ç) Mbrojtjes nga uji;
 - d) Morfologjisë së brigjeve;
 - dh) Deluvioneve dhe aluvioneve të depozituara në vite përgjatë burimit ujq;
 - e) Pjerrësisë së shtratit të burimit ujq;
 - ë) Pjerrësisë së brigjeve;

- f) Infrastrukturës së transportit rrugor, hekurudhor dhe ujëtjes e kullimit, argjinaturat dhe veprat mbrojtëse, portet, të cilat kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bregut në krahasim me atë natyror;
- g) Dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- gj) Garantimit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së bregut të burimeve ujore në harmoni me nevojat për zhvillim urban, si dhe me veprimtaritë ekonomike, sociale e turistike që zhvillohen ose kanë ndikim mbi të.

III. KRITERET E POSAÇME PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË SË BREGUT SIPAS LLOJEVE TË BURIMEVE UJORE

4. Vija bregdetare shënohet me fillimin e bimësisë së përhershme ose kur ka një ndryshim të dukshëm në morfologjinë e nënshtresave ose formës së tokës, p.sh. nga një plazh relativisht i sheshtë në duna kodrinore, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
 - a) Kur në zonën e bregut të detit ka seksione të sistemuara, janë ngritur objekte publike të infrastrukturës së transportit, si rrugë, shëtitore etj., apo të infrastrukturës së mbrojtjes përgjatë bregut nga proceset natyrore detare, vija bregdetare është kufiri i shtrirjes së veprës publike në drejtim të detit;
 - b) Në rastin e porteve detare, zona e bregut të detit konsiderohet territori i tij sipas planeve të përgjithshme vendore (PPV) ose planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare (PDZRK) ose vendimeve të KKT-së për shpalljen e zonave të rëndësisë kombëtare, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 - c) Në rastet kur PPV-të dhe PDZRK-të, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kanë përcaktuar vijën kufi deri ku lejohet zhvillimi i territorit dhe kjo vijë përkon me kriteret e vijës bregdetare sipas këtij vendimi, atëherë ajo vijë do të konsiderohet kufiri i zonës së bregut të detit në drejtim të tokës, përveç seksioneve të sistemuara, për të cilat zbatohen parashikimet e shkronjës “a”, të kësaj pike. Në të kundërt, PPV-të apo PDZRK-të i nënshtrohen rishikimit në ato territore ku vija nuk përkon me kriteret e vijës bregdetare;
 - ç) Në rastet kur në PPV-të apo PDZRK-të nuk parashikohen zhvillime në zonën e bregut të detit dhe kjo krijon mundësinë e zbatimit të nenit 8, të ligjit nr.10234, datë 18.2.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e

- mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”, atëherë zona e bregut të detit do të jetë jo më pak se 100 metra në gjerësi;
- d) Në rastin e brigjeve shkëmbore të thepisura, me pjerrësi të konsiderueshme më shumë se 70° , që përfundojnë drejtpërdrejt në sipërfaqen e detit, sipërfaqja e shpatit të pjerrët së bashku me zonën e sipërme përtej shpatit në drejtim të tokës, e cila është e ndikuar nga proceset bregdetare, konsiderohet zonë e bregut të detit;
- dh) Kur vija kufi e bregut të detit përkon me kufirin natyror të lagunës, zona, distanca dhe gjerësia e bregut detar është dinamike dhe ndjek ndryshimin e regjimit të kufirit të lagunës. Në këtë rast toka e përfluar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit konsiderohet si zonë e bregut të detit;
- e) Në rastin e deltave të lumenjve, limaneve detare dhe ngushticave, si pjesë e ujërave të brendshme detare, vija bregdetare i nënshtrohet kushteve dhe kriterëve për zonën e bregut të detit.
5. Në liqene, rezervuarë, pellgje me ujë, natyrorë apo artificialë, laguna, zona dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale, në të gjithë perimetrin e trupit ujqor, duke krijuar aluvione apo zona të pagjelbëruara me bimësinë karakteristike të përhershme të brezit të tokës, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
- a) Në rastin kur në zonën e bregut të këtyre trupave ujqorë ka seksione të sistemuara, ku janë ngritur objekte publike të infrastrukturës së transportit, si rrugë, shëtitore etj. apo të infrastrukturës së mbrojtjes nga proceset natyrore, zona dhe gjerësia e bregut ka kufi kufirin e shtrirjes së veprës publike në drejtim të trupit ujqor;
- b) Në rastet kur PPV-të apo PDZRK-të, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kanë përcaktuar vijën kufi deri ku lejohet zhvillimi i territorit dhe kjo vijë përkon me kriteret e zonës, distancës dhe gjerësisë së bregut, atëherë ajo vijë do të konsiderohet kufiri i zonës së bregut në drejtim të tokës, përveç seksioneve të sistemuara, për të cilat zbatohen parashikimet e shkronjës “a”, të kësaj pike. Në të kundërt, PPV-të apo PDZRK-të i nënshtrohen rishikimit të plotë ose të pjesshëm në ato territore ku vija nuk përkon me kriteret e vijës së bregut për këta trupa ujqorë;
- c) Në rastin e rezervuarëve artificialë të ujitjes, si nivel maksimal i gjurmës konsiderohet niveli apo perimetri maksimal, që përcaktohet në projektin e ndërtimit të rezervuarit, si dhe kushtëzimet në projekt, nëse ka të tilla, mbi këtë nivel maksimal.

6. Zona, distanca dhe gjerësia e bregut përgjatë lumenjve dhe përrenjve përcaktohen, si më poshtë vijon:
- a) Në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e madhe se 10%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit për prurje me probabilitet 1 herë në 100 vjet ($P=1\%$);
 - b) Në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e madhe se 4% deri në 10%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 5m për pjerrësinë 4% dhe 2m për pjerrësinë 10% në plan, nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);
 - c) Në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është 2% deri 4%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 25m për pjerrësinë 2% dhe 5m për pjerrësinë 4% në plan nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);
 - ç) Në lumenjtë e përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e vogël se 2%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 100m për pjerrësinë 0% dhe 25m në plan për pjerrësinë 2%, nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);
 - d) Në lumenjtë e përrenjtë që kalojnë brenda zonave të urbanizuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore që formohet ndërmjet nivelit maksimal të ujit të seksionit tërthor dhe veprave publike apo atyre që janë në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor, të miratuara;
 - dh) Në lumenjtë e përrenjtë, shtretërit dhe/ose brigjet e të cilëve janë mbrojtur me argjinaturë dhe/ose strukturë gjatësore e tërthore mbrojtëse apo kanë seksione të sistemuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore me ose pa ujë që krijohet ndërmjet argjinaturave, strukturave mbrojtëse, seksioneve të sistemuara dhe vijës ujore.
7. Në kanalet artificiale, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira që krijohet nga vija ujore deri në kuotën e sipërme të skarpatës së kanalit. Në rastet kur ka PPV të miratuara, sipas përcaktimeve në legjislacionin për

planifikimin dhe zhvillimin e territorit, zona dhe gjerësia e bregut është sipas përcaktimeve të planit.

8. Për raste të veçanta të papërcaktuara më sipër apo që rezultojnë nga ndërthurje të parashikimeve të sipërpërmendura, janë organet e menaxhimit të burimeve ujore që interpretojnë zonën, distancën dhe gjerësinë e bregut.

IV. DISPOZITA KALIMTARE

9. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e hartave të brigjeve dhe miratimin, rast pas rasti, në KKU dhe KKT.
10. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit e njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

NR.PROT. 5540/12
DATË 21/2, 2022

KRYEMINISTRISË
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE
UJORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT
AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT
TË GJITHA BASHKIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

